



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 4 mars 2022

Znj. Gresa Caka - Nimani, Kryetare

Gjykata Kushtetuese

Rr. "Perandori Justinian", nr. 44

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën KI 10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit A.nr. 1430/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit AA.nr. 651/2021 të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i përdorimit të mjeteve juridike në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit A.nr. 1430/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit AA.nr. 651/2021 të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme, që kanë të bëjnë me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga z. Bedri Zhegrova, përfaqësues i Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore, lidhur me çështjen e ngritur në Gjykatën Supreme të Kosovës për rishikimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Avokati i Popullit vëren se Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore ka ngritur në Gjykatën Supreme çështjen në fjalë me pretendimin e mospërputhjes së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, përkatësisht me nenin 15 [Veprimtaria e Institutit] të ligjit.

Më tej Avokati i Popullit është njoftuar nga ankuesi se Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykim ARJ 115/2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Më 18 shkurt 2022, Avokati i Popullit është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese se më 25 janar 2022 ka pranuar kërkesë të parashtuar nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e përfaqësuar nga z. Bedri Zhegrova, regjistruar si KI 10/22, me të cilën kontestohet Aktgjykimi ARJ 115/2021 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 18 nëntor 2021.

### **Vlerësimi i Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit ka analizuar kërkesën e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka vërejtur se kjo sindikatë pretendon se Gjykata

Themelore në Prishtinë (GjThP), Gjykata e Apelit (GjA) dhe Gjykata Supreme (GjS), me vendimet e tyre kanë cenuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave e po ashtu të drejtën për mjete juridike.

GjThP-ja, më 5 korrik 2021, ka nxjerrë Aktvendimin A.nr 1430/21, me të cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore. GjThP-ja në arsyetimin e Aktvendimit A.nr. 1430/21 ka konstatuar: *“Rregullorja MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, nuk përbën akt përfundimtar administrativ në kuptimin e nenit 3, paragrafi 1.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe në kuptim të nenit 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, me të cilat është caktuar struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ.”*

GjA-ja, më 6 gusht 2021, ka nxjerrë Aktvendimin AA.nr. 651/2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ka vërtetuar Aktvendimin A.nr 1430/21, i datës 5 korrik 2021.

Rrjedhimisht, Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, më 29 shtator 2021, ka parashtuar në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, që ka marrë numrin ARJ.nr.115/2021.

Më 18 nëntor 2021, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykim ARJ 115/2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Avokati i Popullit thekson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e ligjshmërisë së një rregulloreje në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës.

Më tej Avokati i Popullit vëren se kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së rregullores së theksuar më sipër është refuzuar si e pabazuar nga GjThP-ja, GjA-ja dhe GjS-ja, duke e bërë të paqartë se cili institucion është përgjegjës për vlerësimin e akteve nënligjore apo nëse rregulloret e brendshme konsiderohen akte të përgjithshme, të cilat mund t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Për më tepër, përveç këtij rasti, Avokati i Popullit vazhdimisht pranon ankesa nëpërmjet të cilave i kërkohet paraqitja e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore (udhëzimeve administrative, rregulloreve), të miratuara nga organet e administratës shtetërore apo publike.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit kishte pranuar një ankesë nga Shoqata e Distributorëve Farmaceutikë, nëpërmjet së cilës kërkohet nga Avokati i Popullit që çështjen e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 për Caktimin e Çmimit të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale ta paraqiste në Gjykatën Kushtetuese.

Ndërkohë, Avokati i Popullit ishte vënë në dijeni se Shoqata e Distributorëve Farmaceutikë kishte paraqitur në GjThP, Departamenti për Çështje Administrative, padi për konfliktin administrativ, me ç' rast kjo gjykatë me anë të Aktvendimit A.nr.2886/2019, datë 11.6.2020, kishte hedhur poshtë padinë si të palejueshme. Arsyetimi i dhënë nga kjo gjykatë ishte se, meqenëse në rastin konkret nuk bëhej fjalë për një vendim përfundimtar të organit administrativ, ndërsa kundër udhëzimit administrativ nuk mund të zhvillohej konflikti administrativ dhe se për çështjen në fjalë ishte siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, gjykata kishte vepruar në pajtim me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, me

nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, në përputhje me nenin 34, paragrafi 2. Ankuesit kishin paraqitur ankesë në GjA kundër Aktvendimit A.nr.2886/2019, datë 11.6.2020, të cilën kjo gjykatë nuk e kishte aprovuar, dhe kishte lënë në fuqi Aktvendimin e GjThP-së. Më tej ankuesit kishin parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Vendimit gjyqësor ARJ-UZVP nr. 89/2020, të cilën Gjykata Supreme, më 16 dhjetor 2020, e kishte refuzuar.

Mjetet juridike për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së rregulloreve të brendshme të institucioneve mbeten të vendosen nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa çështja e vlerësimit të ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së udhëzimeve administrative nuk qartësohet krejtësisht me Ligjin Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Për më shumë, praktika e gjykatave të rregullta, konkretisht Aktvendimi A.nr.2886/2019, datë 11.6.2020, sipas të cilit kundër udhëzimit administrativ nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ dhe se për çështjen në fjalë ishte siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, pa dhënë ndonjë sqarim se cila është mbrojtja gjyqësore e siguruar jashtë konfliktit administrativ, krijon një situatë të paqartë juridike, e cila kërkon një zgjidhje që do t'u mundësonte qytetarëve përdorimin efikas të mjeteve juridike.

### **Praktika e Gjykatës Kushtetuese**

Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 112 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.”*

Praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese bën të ditur se palët e autorizuara sipas Kushtetutës, njëra ndër to edhe Avokati i Popullit, mund të kërkojnë vlerësimin e ligjeve apo të vendimeve të miratuara nga Kuvendi, por jo edhe të udhëzimit administrativ i nxjerrë nga ministria.<sup>1</sup>

Po ashtu, praktika e Gjykatës Kushtetuese bën të ditur se Kushtetuta nuk parasheh të drejtën e individëve që të paraqesin kërkesë për kontroll kushtetues abstrakt, gjegjësisht t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese aktet e përgjithshme normative të autoriteteve publike. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës.<sup>2</sup>

Praktika e Gjykatës Kushtetuese bën të ditur se ekzistojnë mjete efektive juridike për vlerësimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë së udhëzimeve administrative dhe të akteve të përgjithshme normative, të cilat duhet të shterohen para se çështja të ngrihet në Gjykatën Kushtetuese.

### **Përfundim**

Duke pasur parasysh rrethanat që u theksuan më sipër, Avokati i Popullit konsideron se është shumë me rëndësi të sqarohet përgjegjësia e institucionit kompetent për vlerësimin e

---

<sup>1</sup> Aktvendimi për Papranueshmëri në rastin KO95/16, Slavko Simic dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: “Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nr.07/2015, të 31 dhjetorit 2015.

<sup>2</sup> Aktvendimi për Papranueshmëri në Rastin nr. KI 16/11, i datës 14 nëntor 2011; Aktvendimi për Papranueshmëri në Rastin nr.KI 40/11 i datës 1 nëntor 2011; Aktvendimi për Papranueshmëri në Rastin nr.KI 122/20 i datës 4 shkurt 2021.

ligjshmërisë së akteve nënligjore. Kjo do të mundësonte vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, por edhe realizimin e së drejtës kushtetuese, përkatësisht nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], sipas të cilit përcaktohet:

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*

Po ashtu, një vlerësim i tillë do t'i kontribuonte edhe zbatimit të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, sipas të cilit:

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

Avokati i Popullit konsideron se situatat e tilla do duhej të përcaktoheshin qartë në dispozitat e ligjeve (Ligjit për Aktet Normative, i cili aktualisht është në shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe Ligji për Konfliktet Administrative, i cili është në fazën e draftimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike). Kjo do të krijonte pasqyrë të qartë se cilat janë akte të përgjithshme normative, cilat nga këto akte i nënshtrohen kontrollit gjyqësor e cilat jo dhe të përcaktohej kompetenca e organit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së akteve të tilla. Prandaj Avokati i Popullit e vlerëson si të domosdoshëm vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjet në fjalë e që drejtpërsëdrejti kanë ndikim në të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe për mjete juridike.

Me nderime,

  
Naim Qelaj

Avokat i Popullit